



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË GJILAN

Prill - Qershor 2024



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjilan, për periudhën kohore Prill - Qershor 2024.

Kryeprokurori Kadriu priti në takim Inspektoratin Qendror të Punës për rajonin e Gjilanit

Gjilan, 16 prill 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu priti në takim udhëheqësen e Inspektoratit Qendror të Punës për rajonin e Gjilanit, znj. Muhabere Konesha dhe Inspektorin e Punës z. Bujar Xhelili.

Po ashtu në këtë takim mori pjesë edhe prokurorja nga Departamenti Përgjithshëm i kësaj prokurorie, znj. Rozelida Manastiri.

Gjatë këtij takimi temë kryesore diskutimi ishte siguria dhe shëndeti në punë, ku rëndësi e veçantë iu kushtua sektorit të ndërtimitarisë në mënyrë që të ndërmerren masa parandaluese sa i përket procesit të punës, me qëllim të evitimit dhe minimizimit të rreziqeve, të cilat shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës.

Kryeprokurori njoftoi të pranishmit se nga Prokuroria Themelore në Gjilan janë trajtuar shumë raste sa i përket aksidenteve në punë ose për shkak të punës dhe se në shumë raste janë ngritur aktakuza.

Në fund të takimit të pranishmit u dakorduan që të vazhdojnë të ndërmarrin masa parandaluese, të cilat kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, përmirësimin e ambientit të punës dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve.



Kryeprokurori Kadriu priti në takim Policinë e Kosovës për regjionin e Gjilanit

Gjilan, 19 prill 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu, ka pritur në takim pune Drejtorin e Policisë Rajonale të Gjilanit, z. Agron Rukiqi, komandantët e stacioneve policore, për regjionin e Gjilanit, udhëheqësit e hetimeve rajonale, si dhe përfaqësuesin e mbrojtësve të viktimave.

Në këtë takim morën pjesë edhe prokurorja koordinatorë për dhunë në familje znj. Leonora Kadriu dhe prokurorë nga Departamenti i Krimeve të Rënda.

Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me ngritjen e bashkëpunimit në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe Policisë, për problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Përpos tjerash u diskutua edhe koordinimi dhe ndërmarrja e veprimeve sa i përket luftimit të kriminalitetit në përgjithësi, në fokus të veçantë trajtimi i rasteve të dhunës në familje, me qëllim të parandalimit dhe ofrimit të sigurisë së viktimave, ngritja e përgjegjësisë, dhe vlerësimi i rrezikshmërisë, me qëllim të ndërmarrjes së masave urgjente që në fazën fillestare të paraqitjes së rasteve.

Në fund të takimit, të dy institucionet vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm dhe shprehën gatishmëri për bashkëpunim të mëtejshëm.





KOMUNIKATË E PËRBASHKËT PËR MEDIA NGA PROKURORIA THEMELORE NË GJILAN DHE POLICIA E KOSOVËS – DREJTORIA RAJONALE NË GJILAN

Gjilan, 30 maj 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, ju njofton se në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës – Drejtorinë Rajonale në Gjilan, pas hetimeve intensive ka ndaluar të dyshuarën N.R., për shkak të veprës penale “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

E dyshuara e lartshënuar më datë 25 Maj 2024, rreth orës 00:56, ka raportuar se derisa kishte qenë duke ecur tek varrezat e qytetit në Gjilan së bashku me djalë e saj, ishte ndaluar nga dy persona të maskuar, të cilët nën kërcënim e kishin tërhequr brenda rrethojës së varrezave, ku pastaj sipas saj e kishin dhunuar seksualisht dhe ia kishin grabitur me forcë stolitë e arit.

Prokuroria Themelore në Gjilan, në koordinim të plotë me Njësinë e Hetimeve Rajonale në Gjilan, me qëllim të zbardhjes së këtij rasti kanë ndërmarrë veprime intensive hetimore, ku bazuar në provat e marra, deklaratimet e palëve të përfshira në rast, raportet mjekësore nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, analizimit të shumë materialeve me video-incizime janë siguruar dëshmi se gjithë ngjarja ka qenë një inskenim dhe e njëjta ka raportuar rrejtshëm me rastin e lajmërimit të saj në polici.

Me urdhër të prokurorit e dyshuara gjendet në ndalim 48 orësh dhe ndaj të njëjtës brenda afatit ligjor do të vendoset rreth masës për sigurimin e pranisë në procedurë penale

Aktakuzë për mashtrim

Gjilan, 12 qershor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit D.A., për shkak të veprës penale “Mashtrimi”, nga neni 323 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, ekziston dyshimi i bazuar mirë se, i pandehuri D.A., që nga data 24 dhjetor 2023 deri më datë 28 mars 2024, në vazhdimësi, në biznesin e tij të emërtuar, “Albshkolla”, në Gjilan, me anë të paraqitjes së fakteve të rreme dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, i ka vënë në lajthim të dëmtuarit I.K., L.H., V.M., F.O., J.S., Y.B., A.V., M.A., R.A., N.S., A.R., duke i mashtruar dhe nxitur që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, në atë mënyrë që i njëjti ka hapur një shkollë të rreme online të quajtur “Albshkolla”, duke punësuar të dëmtuarit si mësime dhe pozita të tjera, me të cilët ka nënshkruar kontrata me kohë të caktuar dhe ka premtuar paga nga 400 euro deri në 1,000 euro, ku të dëmtuarit, duke rënë pre e mashtrimit, kanë

filluar punën, duke dhënë shërbim secili në pozitën dhe rolin e tij, mirëpo i njëjti për këto shërbime nuk i ka paguar.

Po ashtu i njëjti gjatë muajit shkurt 2024, nga e dëmtuara Y.B., ka marrë një pllakë të arit kinse për t'ia rregulluar, të cilën më nuk ia ka kthyer, e po ashtu përmes platformës së tij të rreme ka nxitur persona të tjerë të paguajnë shumën prej 12 euro, në llogarinë e tij "Albshkolla" për shërbime online, e që ky shërbim nuk iu ishte ofruar asnjëherë.

Për këto veprime, i pandehuri D.A., ka kryer veprën e sipërshtënuar penale, për të cilën me kërkesë të prokurorisë gjendet nën masën e paraburgimit.

Prokuroria Themelore në Gjilan në tremujorin e dytë 2024 ka zgjidhur 32 raste përmes procedurës së ndërmjetësimit

Prill – Qershor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, në tremujorin e dytë të vitit 2024, saktësisht në periudhën Prill – Qershor 2024, për veprat penale të cilat janë të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet apo me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, ka referuar gjithsej pesëdhjetetë (53) lëndë me gjashtëdhjetepesë (65) persona, që të zgjidhen përmes procedurës së ndërmjetësimit,

Përmes kësaj procedure, nga të gjitha rastet e referuara janë zgjidhur gjithsej tridhjetedy (32) lëndë me tridhjetenëntë (39) persona, për veprat penale "Kanosja", "Sulmi", "Lëndimi i lehtë trupor", "Keqpërdorimi i besimit", "Vjedhja e shërbimeve", "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë", "Vetëgjyqësia", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.


Gjatë kësaj periudhe kohore përmes procedurës së ndërmjetësimit, pavarësisht referimit të rasteve nuk janë zgjidhur njëzet (20) lëndë me njëzetedy (22) persona, pasi që nuk është arritur pëlqimi në mes të pandehurve dhe të dëmtuarve, si dhe një (1) rast me tre (3) persona është në procedurë.

Të dhënat e përgjithshme statistikore sipas llojit të kallëzimit penal

Prill - Qershor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan ka pranuar gjithsejtë 824 lëndë (nga regjistri PP, PPN, PPP dhe NJN), ndërsa ka zgjidhur 822 lëndë, në një efikasitet të përgjithshëm të trajtimit të rasteve prej **99.75 %**.

Përmes grafikoni të mëposhtëm, pasqyrohen të dhënat e përgjithshme sipas llojit të kallëzimit penal/llojit të regjistrit.



*Grafikoni 1: Paraqet të dhënat e përgjithshme statistikore sipas llojit të kallëzimit penal për periudhën
Prill – Qershor 2024*